



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2592/ 7 prot.

Datë 24.09.2024

V E N D I M

Nr. 1323/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.09.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “Gentjan Kadriu” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-11540-06-28-2024, me objekt: Loti IV “Blerje Ushqime Koloniale me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj”, me fond limit 637,906 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatë e nëntëqind e gjashtë) lekë pa TVSH ose 6,361 (gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 27.06.2024 është 100.28 lekë nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Gentjan Kadriu” P.F me NIPT K81630012E dhe adresë: Rruga “Siri Kodra”, Banesë Private, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, 1001, Tiranë.

Subjekti i Interesuar: Operatori ekonomik “M.C.Catering” SHPK me NIPT K72218022J me adresë: Rruga “Pjeter Budi”, Nd.29, H3, Ap.14, Njesia Administrative nr.2, 1010, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.07.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr. REF-11540-06-28-2024, me objekt: Loti IV “*Blerje Ushqime Koloniale me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj*”, me fond limit 637,906 (*gjashtëqind e tridhjetë e shtatë e nëntëqind e gjashtë*) lekë pa TVSH ose 6,361 (*gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një*) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 27.06.2024 është 100.28 lekë nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a

II.2. Në datën 12.08.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 19.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Gentjan Kadriu” P.F	542,880	lekë	skualifikuar
2. “M.C Catering” ShPK	557,176	lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik më datë 06.09.2024, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraparak.

II.5. Në datën 13.09.2024, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër elektronik A/2024/4555, dhe me nr. 2592/2024 prot, datë 13.09.2024, e operatorit ekonomik “*Gentjan Kadriu*” P.F. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Gentjan Kadriu*” PF, me argumentat si mëposhtë vijon:

Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit:

Arsyeja: Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik të kriterëve të veçanta të Kualifikimit, pasi nuk vërteton se ka realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme artikujt objekt prokurimi. Për vërtetimin e këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur fatura furnizimi, të cilat janë të gjitha për një produkt/artikull të vetëm i jufkaë, ndërkohë që referuar shtojcës 6, për lotin IV ushqime koloniale kërkohen 20 artikuj ushqimorë të ndryshëm.

Në pikën 1, të seksionit 2.3 të DT, është kërkuar;

- 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në pikën 4, të nenit 20 të RRPP-së, parashikohet: për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në cdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Subjekti Gentjan Kadriu PF ka dorëzuar si pjesë të ofertës së tij fatura shitje të realizuara me subjekte private në një vlerë shumë herë më të madhe se ajo e kërkuar në dokumentet e tenderit. Në këto fatura zëri i shitur është Jufka (makarona). Për të cilat subjekti jonë është jo vetëm tregëtues i tyre por edhe prodhues prej shume vitesh.

Si në kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit ashtu edhe në ligjin dhe rregullat për prokurimin publik, kërkesa për këtë pikë është të vërtetohet përvoja e ngjashme, dhe në asnjë moment nuk është kërkuar se furnizimet apo përvoja e mëparshme duhet të jetë e njëjtë. Jufkat për të cilat ne kemi paraqitur dokumentacion janë një nga disa llojet e makaronave, ashtu si Makarona peta të kërkuara në shtojcën 6, e cila nuk përfshihet në asnjë objekt tjetër si bulmet, vezë, mish, fruta apo objekt tjetër, por është zë brenda ushqimeve koloniale. Theksojmë se, Makaronat janë një nga zërat e kërkuara në sasi dhe grafikun e lëvrimin në këtë procedurë prokurimi, si rrjedhojë janë edhe një produkt pjesë e ushqimeve koloniale. Në arsyet e skualifikimit është cituar: se është paraqitur vërtetim për furnizimet e ngjashme për produktin jufka, ndërkohë që referuar shtojcës 6 për lotin IV ushqime Koloniale, kërkohen mbi 20 artikuj ushqimor të ndryshëm.

Lidhur me këtë arsyetim atëherë natyrshëm lind pyetja nëse KVO kërkon që të kemi pjesë të furnizimeve tona 20 artikujt e vendosura në këtë shtojcë. Nëse po, kjo do të ishte diskriminuese, dhe skemi të bëjmë më me kërkesë për furnizime të ngjashme por të njëjta. Kuptojmë se vlerësimi është bërë mbi bazën e përvojës së njëjtë, duke rënë ndesh me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe bazës ligjore për prokurimin publik për furnizimet e

ngjashme. Dokumentacioni i paraqitur nga ana jonë përmbush kërkesën e vendosur në pikën 1 të seksionit 2.3, duke vërtetuar se kemi përvojën e duhur për përmbushjen me sukses të kësaj kontrate. Gjithashtu përvec sa më sipër sjellim në vëmendjen tuaj se oferta e paraqitur prej nesh është oferta me e ulët ekonomike, duke plotësuar dhe qëllimin e këtij ligji si të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; dhe) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; Kërkojmë nga KSHA dhe KPP, të marri në konsideratë argumentet dhe parashtrimet e bëra më sipër dhe kualifikimin e subjektit tonë lidhur me këtë pikë.

II. Lidhur me pikën e dytë të skualifikimit

Arsyeja skualifikimi: Nuk plotëson shkronjën a), të pikës 6, të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik të Kriteve të vecanta të kualifikimit, lidhur me disponimin e 1 (një) stabilimenti, në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 për ushqiminë. Licenca LN-7924-05-2024 e paraqitur nga operatori ekonomik nuk ka si vend të kryerjes së veprimtarisë stabilimentin e deklaruar nga operatori ekonomik në kontratën e qerasë nr. Repertori 2717, nr. Koleksioni 1052, datë 10.08.024. Gjithashtu, stabilimenti i deklaruar nga operatori ekonomik nuk është i regjistruar si vend i ushtrimit të aktivitetit as në ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar të operatorit.

Në pikën 6.a të seksionit 2.3, të dokumenteve të tenderit është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- Çertifikatë pronarie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin.
- Licencën e kategorisë “II.1.A.1, për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës “a” të këtij kriteri.

Subjekti jonë në përmbushje të këtij kriteri ka dorëzuar në SPE dukumentacion kontratë qeraje që vërteton disponimin e stabilimentit si dhe licencë të kategorisë II.1A.1.

- Në kontratën e qerasë për stabilimentin, specifikohet: objekti i kontratës 1.1 Pala qiradhënëse është pronare e ligjshme një pasurie të palijtshme truall+ndërtesë, trualli me sipërfaqe 385 m2, sipërfaqe e zënë me ndërtesë 343 m2, e ndodhur në adresë Rr. Siri Kodra, Nd 574, tiranë, vërtetuar me certifikatë Regjistrimi pronësie datë lëshimi 15/08/2023, lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri. Pasuria ka të dhënat hipotekore: Kodi Unik 8340029238, pasuria nr. 1/1645, Zona Kadastrale 8340, V.29, F. 238. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera e kësaj njësie shërbimi, për sipërfaqen 150 m2 (njëqind e pesëdhjetë metër katror).

- Në licencën e dorëzuar, në kategorinë e adresës përcaktohet: Adresa: Tiranë, Tiranë , Rruga Siri Kodra, banesë Private. Vendi i Kryerjes së veprimtarisë: Qyteti Tiranë, Rr. Tiranë, B/K: Tiranë, Q/F: Tiranë, Rruga Siri Kodra, banesë Private.

- Në ekstraktin e thjeshtë dhe atë historik të kompanisë, në kategorinë, shprehet: Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Tirane Tirane Tiranë Rruga Siri Kodra, Banese Private në të tre

dokumentet e dorëzuar dhe të përmendur me sipër adresa e aktivitetit është në rrugën Siri Kodra, dhe gjithashtu bëhet fjalë për ndërtesë private. Në dokumentet e dorëzuara, nuk kemi të bëjmë me të dhëna kontraditore lidhur me adresën e subjektit, gjë e cila do të bënte të dilej në konkluzionin se adresat ishin të ndryshme. Adresa e Stabilimentit është ajo adresë e cila është pasqyruar në ekstraktin historik të shoqërisë dhe në kontratën e qerasë, vetëm se në këtë të fundit janë shtuar të dhëna të tjera plotësuese.

Licenca LN-7924-05-2024 e paraqitur nga ne, ka si vend të kryerjes së veprimtarisë stablimentin e deklaruar në kontratën e qerasë nr. Repertori 2717, nr. Koleksioni 1052, datë 10.08.024, në të cilën termit ndërtesë private i është shtuar edhe numri përkatës i ndërtesës. Në kontratën e qerasë janë përmendur të dhënat e plota të ndërtesës sipas certifikatë Regjistrimi pronësie, pasi noterja e cila ka hartuar këtë kontratë ka specifikur cdo të dhënë të kësaj certifikate për ta bërë më të plotë dhe të dallueshëm objektin e pasurisë, ndërkohë që në licencë dhe ekstrakt kjo vendodhje është pasqyruar në mënyrë më të përmbledhur.

Bëjmë me dije se kompania jonë kryen aktivitetin në këtë adresë që prej vitit 2008, dhe është Licencuar për kryerjen e aktivitetit në këtë adresë që prej vitit 2014, dhe në atë kohë është deklaruar adresa në mënyrë të përmbledhur, duke u shprehur itiranë, tiranë , Rruga Siri Kodra, banesë Private. Theksojmë edhe një herë se kryejmë aktivitetin në këtë stabiliment/ godinë prej vitësh, dhe jemi subjekt i kontroleve të rregullta nga AKU, dhe cdo institucion tjetër kontrollues lidhur me Ushqimin dhe aktivitetin tonë tregtar, dhe marrdhënia me pronarin e pasurisë është prej vitësh. Kontrata e qerasë e dorëzuar në SPE është e rinovuar sëfundmi dhe në të janë pasqyruar të dhëna Më të plota sipas kartelës së rifreskuar nga pronari i pasurisë.

Për sa kohë, në dokumentet e dorëzuar nuk kemi të dhëna të cilat tregojnë adresa të ndryshme, por vetëm plotësim të dhënash në njërin prej dokumenteve, gjykojmë se, në rast se komisioni i Vlerësimit të ofertave kishte paqartësi apo dyshime duhet të kishte ezauruar mundësisë e kërkesës së shpjegimeve apo provimit të këtij dyshimi.

Ne jemi të gatshëm dhe ju motivojmë të kryeni verifikime në ambientet tona për të provuar përkueshmërinë e këtyre adresave.

Per gjithë sa më sipër kërkojmë pranimin e ankeses dhe kulifikimin e ofertës sonë, si një oferte që përmbush kerkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe oferta ekonomikisht me e favorshme.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2592/2 prot., datë 16.09.2024, duke publikuar arsyet e skualifikimit të cilat ankimuesi “Gentjan Kadriu” PF pretendon se përmbushen nga ana e tij.

II.7. Me anë të shkresës Nr. 716/34 prot., datë 23.09.2024, protokolluar me tonë me nr. 2592/4 prot., datë 24.09.2024, me objekt “Dërgim Vendimi”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës nr. 716/33 prot, datë 20.09.2024 të operatorit ekonomik ankimues “Gentjan Kadriu” PF, ku konstatohet, se e ka pranuar plotësisht ankesën me përmbajtje si më poshtë vijon:

Arsyeton:

Lidhur me pretendimin e pare te operatorit ekonomik :Gentjan Kadriu” P.F, mbi kundërshtimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave ne lidhje me skualifikimin e ofertes se tij me arsyen se: "Nuk plotison pikën 1 te seksionit 2.3 Kapacitet Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Deshmi per furnizime te ngjashme), pasi vera totale e faturave te derguara ne SPE (vetem per artikuj te ngjashem me objektin e prokurimit) nuk ploteson limitin prej 19% te Fondit limit.

KSHA arsyeton se:

1. Në pikën 2.3 te DT “Kapaciteti Teknik” nimpika 1 eshte percaktuar si me poshte vijon: Operatori ekonomik duhet te paraqese dishmi per furnizimet e meparshme te ngjashme të kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, në vlerën jo më pak se 19% e vleres se fondit limit te ketij loti. Këto furnizime te mëparshme, te ngjashme, duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:

- 1. Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetimin e leshuar nga enti publik per permbushjen me sukses te kontrates, dhe/ose faturat tatimore te shitjes te plotisuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara.*
- 2. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.*

KSHA verson se kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatorive ekonomike, te cilët, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te jera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithkcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne këte kuptim, per Autoritetin Kontraktor eshte e rendësishme te provohet operatori ekonomik zoteron eksperiencat e mëparshme te ngjashme me kontratën objekt prokurimi, ne perputhje me kerkesat e parashikuara ne dokumentat e tenderit si dhe regullat e prokurimit publik.

Operatori ekonomik "Gentjan Kadriu" PF me dokumentacionin e paraqitur ne SPE verteton se permbush kerkesat per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe konkretisht:

"Ploteson piken 1 te Kapacitetit Teknik (Deshmi per furnizimet e ngjashme) pasi vlere totale e faturave te derguara ne SPE (vetem per artikujt e ngjashem me objektin e prokurimit) ploteson limitin prej 19% te Fondit limit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te sipercituar, te paraqitur nga operatori ekonomik "Gentjan Kadriu" PF, ne funksion te permbushjes te kriterit teknik per furnizime te ngjashme gjate tre viteve te fundit, KSHA konstaton se ankimuesi, deshmon se ka kryer furnizime te ngjashme. Konkretisht, zerat e faturave te paraqitura nga ankimuesi konsistojne kryesisht ne blerje jufka te cilat klasifikohen si ushqime koloniale. Subjekti "Gentjan Kadriu" PF ka dorezuar si pjesë te ofertës se tij fatura shitje te realizuara me subjekte private ne nje vlere shume here me te madhe se ajo e kerkuar ne dokumentet e tenderit. Gjithashtu, KSHA gjykon se per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme me furnizimet objekt prokurimi, por edhe ne perputhje me volumin e percaktuar ne dokumentat e tenderit, si dhe, krahasueshmeria e kontratave nese jane te ngjashme nuk i referohet vetem natyrës se kontratave por edhe zerave konkrete te tyre, si artikuj, pajisje apo produkte. Ne kete prizem elementet konkrete te faturave te paraqitura ne SPE jane te ngjashme me objektin e procedures se prokurimit ne fjale.

Nga shqyrtimi ne teresi i dokumentacionit te dorezuar nga operatori ekonomik "Gentjan Kadriu" P.F, ne mbeshetete te deshmimit per furnizimet e mëparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne vleren jo me pak se 19% e vleres së fondit limit, vleresojme se operatori ekonomik "Gentjan Kadriu" P.F, ne rastin konkret ka arritur nepermjet dokumentacionit provues sa me siper, te argumentoje se e permbush kete kriter te percaktuar ne DT.

Per sa me siper, pretendimi i ankimuesit qëndron.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Gentjan Kadriu" P.F, mbi kundershkrimin e vendimit te Komisionit te Vlerisimit te Ofertave ne lidhje me skualifikimin e ofertës se tij me arsyen se: nuk ploteson shkronjën a) te pikes 6 te seksionit 2.3 kapaciteti teknik te kriterëve te veçanta te kualifikimit, lidhur me disponimin e 1 (një) stabilimenti, ne zbatim te nenit 19, te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 "Për ushqimin". Licenca In-7924-05-2024 e paraqitur nga operatori ekonomik nuk ka si vend te kryerjes se veprimtarise stablimentin e deklaruar nga operatori ekonomik ne kontratin e qerase nr. repertori 2717, nr. koleksioni 1052, date 10.08.024. Gjithashtu, stabilimenti i deklaruar nga operatori ekonomik nuk eshte i regjistruar si vend i ushtrimit të aktivitetit as ne ekstraktin historik te regjistrit tregtar te operatorit.

KSHA gjykon se nga shqyrtimi i dokumentacionit te ngarkuar ne SPE nga OE ankimues "Gentjan Kadriu" P.F, konkretisht Licencë LN-792-05-2014, Kontrate Qiraje dhe Ekstraktin e QKB, ky OE e permbush kete kriter kerkuar ne DT. KSHA vlerson se ne te tre dokumentet e

ngarkuar ne SPE dhe te permendur me siper adresa e aktivitetit ishte ne rrugen "Siri Kodra" dhe gjithashtu behet fjalë per ndertese private. Pra, adresa e stabilimentit eshte ajo adrese e cila shte pasqyruar ne ekstraktin historik te shoqerise, ne Licence dhe ne kontraten e qirase. Nëpermjet dokumenteve te paraqitura si me siper, OE "Gentjan Kadriu" PF arrin te provoje se e permbush me sukses kriterin e veçante te kualifikimit lidhur me disponimin e nje stabilimenti per kryerjen e veprimtarise ne adresën e deklaruar ne kontraten e qirase per ushtrimin e kesaj veprimtarie.

Per sa me siper, pretendimi i ankimuesit qendron.

Per keto arsye

Bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, zyrtaret e ngarkuar per shqyrtimin e ankeses,

VENDOSEN

1. Pranimin e plote te ankeses te paraqitur nga operatori ekonomik "Gentjan Kadriu" P.F.
2. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre ankimuesin, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi.
3. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre operatorët ekonomike te interesuar, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi.
4. Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates.
5. Ky vendim i njoftohet menjehere Titullarit te Organit Qëndror Bleres.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Gentjan Kadriu" PF mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin se: "**Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit: Arsyeja: Nuk plotëson pikën 1 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik të kriterëve të veçanta të Kualifikimit, pasi nuk vërteteton se ka**

realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme artikujt objekt prokurimi. Për vërtetimin e këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur fatura furnizimi, të cilat janë të gjitha për një produkt/artikull të vetëm i jufkaë, ndërkohë që referuar shtojcës 6, për lotin IV ushqime koloniale kërkohe 20 artikuj ushqimorë të ndryshëm. Në pikën 1, të seksionit 2.3 të DT, është kërkuar; 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara; b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në pikën 4, të nenit 20 të RRPP-së, parashikohet: për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në cdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Subjekti Gentjan Kadriu PF ka dorëzuar si pjesë të ofertës së tij fatura shitje të realizuara me subjekte private në një vlerë shumë herë më të madhe se ajo e kërkuar në dokumentet e tenderit. Në këto fatura zëri i shitur është Jufka (makarona). Për të cilat subjekti jonë është jo vetëm tregëtues i tyre por edhe prodhues prej shume vitesh. Si në kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit ashtu edhe në ligjin dhe rregullat për prokurimin publik, kërkesa për këtë pikë është të vërtetohet përvoja e ngjashme, dhe në asnjë moment nuk është kërkuar se furnizimet apo përvoja e mëparshme duhet të jetë e njëjtë. Jufkat për të cilat ne kemi paraqitur dokumentacion janë një nga disa llojet e makaronave, ashtu si Makarona peta të kërkuara në shtojcën 6, e cila nuk përfshihet në asnjë objekt tjetër si bulmet, vezë, mish, fruta apo objekt tjetër, por është zë brenda ushqimeve koloniale. Theksojmë se, Makaronat janë një nga zërat e kërkuara në sasi të madhe dhe grafikun e lëvrimin në këtë procedurë prokurimi, si rrjedhojë janë edhe një produkt pjesë e ushqimeve koloniale. Në arsyet e skualifikimit është cituar: se është paraqitur vërtetim për furnizimet e ngjashme për produktin jufka, ndërkohë që referuar shtojcës 6 për lotin IV ushqime Koloniale, kërkohe mbi 20 artikuj ushqimor të ndryshëm. Lidhur me këtë arsyetim atëherë natyrshëm lind pyetja nëse KVO kërkon që të kemi pjesë të furnizimeve tona 20 artikujt e vendosura në këtë shtojcë. Nëse po, kjo do të ishte diskriminuese, dhe skema të bëjmë më me kërkesë për furnizime të

ngjashme por të njëjta. Kuptojmë se vlerësimi është bërë mbi bazën e përvojës së njëjtë, duke rënë ndesh me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe bazës ligjore për prokurimin publik për furnizimet e ngjashme. Dokumentacioni i paraqitur nga ana jonë përmbush kërkesën e vendosur në pikën 1 të seksionit 2.3, duke vërtetuar se kemi përvojën e duhur për përmbushjen me sukses të kësaj kontrate. Gjithashtu përvec sa më sipër sjellim në vëmendjen tuaj se oferta e paraqitur prej nesh është oferta me e ulët ekonomike, duke plotësuar dhe qëllimin e këtij ligji si të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; dhe) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; Kërkojmë nga KSHA dhe KPP, të marri në konsideratë argumentet dhe parashtrimet e bëra më sipër dhe kualifikimin e subjektit tonë lidhur me këtë pikë. **Lidhur me pikën e dytë të skualifikimit** Arsyeja skualifikimi: Nuk plotëson shkronjën a) , të pikës 6, të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik të Kriteve të vecanta të kualifikimit, lidhur me disponimin e 1 (një) stabilimenti, në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 për ushqiminë. Licenca LN-7924-05-2024 e paraqitur nga operatori ekonomik nuk ka si vend të kryerjes së veprimtarisë stabilimentin e deklaruar nga operatori ekonomik në kontratën e qerasë nr. Repertori 2717, nr. Koleksioni 1052, datë 10.08.024. Gjithashtu, stabilimenti i deklaruar nga operatori ekonomik nuk është i regjistruar si vend i ushtrimit të aktivitetit as në ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar të operatorit. Në pikën 6.a të seksionit 2.3, të dokumenteve të tenderit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Per ushqimin”. Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet: - Çertifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin. - Licencën e kategorisë “II.1.A.1, për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës “a” të këtij kriteri. Subjekti jonë në përmbushje të këtij kriteri ka dorëzuar në SPE dukumentacion kontratë qeraje që vërteton disponimin e stabilimentit si dhe licencë të kategorisë II.1A.1. - Në kontratën e qerasë për stabilimentin, specifikohet: objekti i kontratës 1.1 Pala qiradhënëse është pronare e ligjshme një pasurie të palijtshme truall+ndërtesë, trualli me sipërfaqe 385 m2, sipërfaqe e zënë me ndërtesë 343 m2, e ndodhur në adresë Rr. Siri Kodra, Nd 574, tiranë, vërtetuar me certifikatë Regjistrimi pronësie datë lëshimi 15/08/2023, lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Veri. Pasuria ka të dhënat hipotekore: Kodi Unik 8340029238, pasuria nr. 1/1645, Zona Kadastrale 8340, V.29, F. 238. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera e kësaj njësie shërbimi, për sipërfaqen 150 m2 (njëqind e pesëdhjetë metër katror). - Në licencën e dorëzuar, në kategorinë e adresës përcaktohet: Adresa: Tiranë, Tiranë , Rruga Siri Kodra, banesë Private. Vendi i Kryerjes së veprimtarisë: Qyteti Tiranë, Rr. Tiranë, B/K: Tiranë, Q/F: Tiranë, Rruga Siri Kodra, banesë Private. - Në ekstraktin e thjeshtë dhe atë historik të kompanisë, në kategorinë, shprehet: Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Tirane Tirane Tiranë Rruga Siri Kodra, Banese Private në të tre dokumentet e dorëzuar dhe të përmendur me sipër adresë e aktivitetit është në rrugën Siri Kodra, dhe gjithashtu bëhet fjalë për ndërtesë private. Në dokumentet e dorëzuara, nuk kemi të bëjmë me të dhëna kontraditore lidhur me adresën e subjektit, gjë e cila do të bënte të dilej në konkluzionin se adresat ishin të ndryshme. Adresa e Stabilimentit është ajo adresë e cila është pasqyruar në ekstraktin historik të shoqërisë dhe në kontratën e qerasë, vetëm se në këtë të fundit janë shtuar të dhëna të tjera plotësuese. Licenca LN-7924-05-2024 e paraqitur nga ne, ka si vend të kryerjes së veprimtarisë stabilimentin e deklaruar në kontratën e qerasë nr. Repertori 2717, nr. Koleksioni 1052, datë 10.08.024, në

të cilën termit ndërtesë private i është shtuar edhe numri përkatës i ndërtesës. Në kontratën e qerasë janë përmendur të dhënat e plota të ndërtesës sipas certifikatë Regjistrimi pronësie, pasi noterja e cila ka hartuar këtë kontratë ka specifikur cdo të dhënë të kësaj certifikate për ta bërë më të plotë dhe të dallueshëm objektin e pasurisë, ndërkohë që në licencë dhe ekstrakt kjo vendodhje është pasqyruar në mënyrë më të përmbledhur. Bëjmë me dije se kompania jonë kryen aktivitetin në këtë adresë që prej vitit 2008, dhe është licencuar për kryerjen e aktivitetit në këtë adresë që prej vitit 2014, dhe në atë kohë është deklaruar adresa në mënyrë të përmbledhur, duke u shprehur itiranë, tiranë , Rruga Siri Kodra, banesë Private. Theksojmë edhe një herë se kryejmë aktivitetin në këtë stabiliment/ godinë prej vitesh, dhe jemi subjekt i kontroleve të rregullta nga AKU, dhe cdo institucion tjetër kontrollues lidhur me Ushqimin dhe aktivitetin tonë tregtar, dhe marrdhënia me pronarin e pasurisë është prej vitesh. Kontrata e qerasë e dorëzuar në SPE është e rinovuar sëfundmi dhe në të janë pasqyruar të dhëna Më të plota sipas kartelës së rifreskuar nga pronari i pasurisë. Për sa kohë, në dokumentet e dorëzuar nuk kemi të dhëna të cilat tregojnë adresa të ndryshme, por vetëm plotësim të dhënash në njërin prej dokumenteve, gjykojmë se, në rast se komisioni i Vlerësimit të ofertave kishte paqartësi apo dyshime duhet të kishte ezauruar mundësisë e kërkesës së shpjegimeve apo provimit të këtij dyshimi. Ne jemi të gatshëm dhe ju motivojmë të kryeni verifikime në ambientet tona për të provuar përkueshmërinë e këtyre adresave. Per gjithë sa më sipër kërkojmë pranimin e ankeses dhe kulifikimin e ofertës sonë, si një oferte që përmbush kerkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe oferta ekonomikisht me e favorshme” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stabiliment, ne zbatim të nenit 19 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”. Për të provuar këtë kriter duhet të paraqesë dokumentet:

- a) Çertifikatë pronësie ose kontratë noteriale qiraje/perdorimi të vlefshme, për stabilimentin.
- b) Licencen e kategorisë “II.1.A.1, për stabilimentin që ka paraqitur dokumentet sipas gërmës “a” të këtij kriteri.

Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas tabelës 1 nëse është **prodhues**. Nëse operatori ekonomik është **tregtues** duhet të deklarohet sipas tabelës 2, kontratat e furnizimit të lidhura me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga prodhuesi, për artikujt objekt prokurimi.

Tabela 1. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si prodhues i mallit.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhues. Të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite
1		
2		
Etj.,		

Tabela 2. Forma e deklaramit për operatorin ekonomik që paraqitet si tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Nr.	Emertimi i artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar Të dhëna të plota të si: telefon, fax, e-mail, ëbsite	Data e fillimit të kontratës se furnizimit	Data e perfundimit te kontratës se furnizimit
1				
2				
Etj.,				

Shenim: Kriteri nr.7 konsiderohet i permbushur me plotesimin e vetëdeklarimit, sipas tabelës së mësipërme. Kontratat e furnizimit të kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet

teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

III.1.3. Me anë të shkresës Nr. 716/34 prot., datë 23.09.2024, protokolluar me tonë me nr. 2592/4 prot., datë 24.09.2024, me objekt “Dërgim Vendimi”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës nr. 716/33 prot, datw 20.09.2024 të operatorit ekonomik ankimes “Gentjan Kadriu” PF, ku konstatohet, se e ka pranuar plotësisht ankesën me përmbajtje si më poshtë vijon: [...] **Arsyeton:** Lidhur me pretendimin e pare te operatorit ekonomik :Gentjan Kadriu” P.F, mbi kundershkrimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave ne lidhje me skualifikimin e ofertes se tij me arsyen se: "Nuk plotison piken 1 te seksionit 2.3 Kapacitet Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Deshmi per furnizime te ngjashme), pasi vera totale e faturave te derguara ne SPE (vetem per artikuj te ngjashem me objektin e prokurimit) nuk ploteson limitin prej 19% te Fondit limit. KSHA arsyeton se: Në pikën 2.3 te DT “Kapaciteti Teknik” nëpika 1 është percaktuar si me poshte vijon: Operatori ekonomik duhet te paraqese dishmi per furnizimet e meparshme te ngjashme të kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, në vlerën jo më pak se 19% e vleres se fondit limit te ketij loti. Këto furnizime te mëparshme, te ngjashme, duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte: - Kur furnizimet e ngjashme jane realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetimin e leshuar nga enti publik per permbushjen me sukses te kontrates, dhe/ose faturat tatimore te shitjes te plotisuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave të furnizuara. - Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara. KSHA verson se kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatorive ekonomike, te cilët, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te jera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithkcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne këte kuptim, per Autoritetin Kontraktor eshte e rendësishme te provohet operatori ekonomik zoteron eksperiencat e mëparshme te ngjashme me kontratën objekt prokurimi, ne perputhje me kerkesat e parashikuara ne dokumentat e tenderit si dhe regullat e prokurimit publik. Operatori ekonomik “Gentjan Kadriu” PF me dokumentacionin e paraqitur ne SPE verteton se permbush kerkesat per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe konkretisht: “Ploteson piken 1 te Kapacitetit Teknik (Deshmi per furnizimet e ngjashme) pasi vlera totale e faturave te derguara ne SPE (vetem per artikujt e ngjashem me objektin e prokurimit) ploteson limitin prej 19% te Fondit limit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te sipercituar, te paraqitur nga operatori ekonomik “Gentjan Kadriu” PF, ne funksion te

permbushjes te kriterit teknik per furnizime te ngjashme gjate tre viteve te fundit, KSHA konstaton se ankimesi, deshmone se ka kryer furnizime te ngjashme. Konkretisht, zerat e faturave te paraqitura nga ankimesi konsistojne kryesisht ne blerje jufka te cilat klasifikohen si ushqime koloniale. Subjekti "Gentjan Kadriu" PF ka dorezuar si pjesë te ofertes se tij fatura shitje te realizuara me subjekte private ne nje vlere shume here me te madhe se ajo e kerkuar ne dokumentet e tenderit. Gjithashtu, KSHA gjykon se per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme me furnizimet objekt prokurimi, por edhe ne perputhje me volumin e percaktuar ne dokumentat e tenderit, si dhe, krahasueshmeria e kontratave nese jane te ngjashme nuk i referohet vetem natyrës se kontratave por edhe zerave konkrete te tyre, si artikuj, pajisje apo produkte. Ne kete prizem elementet konkrete te faturave te paraqitura ne SPE jane te ngjashme me objektin e procedures se prokurimit ne fjale. Nga shqyrtimi ne teresi i dokumentacionit te dorezuar nga operatori ekonomik "Gentjan Kadriu" P.F, ne mbeshetjete te deshmimit per furnizimet e mëparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, ne vleren jo me pak se 19% e vleres së fondit limit, vleresojme se operatori ekonomik "Gentjan Kadriu" P.F, ne rastin konkret ka arritur nepermjet dokumentacionit provues sa me siper, te argumentojte se e permbush kete kriter te percaktuar ne DT. **Per sa me siper, pretendimi i ankimesit qëndron.** Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes "Gentjan Kadriu" P.F, mbi kundershkrimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave ne lidhje me skualifikimin e ofertes se tij me arsyen se: nuk ploteson shkronjën a) te pikes 6 te seksionit 2.3 kapaciteti teknik te kriterave te veçanta te kualifikimit, lidhur me disponimin e 1 (një) stabilimenti, ne zbatim te nenit 19, te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 "Për ushqimin". Licenca In-7924-05-2024 e paraqitur nga operatori ekonomik nuk ka si vend te kryerjes se veprimtarise stablimentin e deklaruar nga operatori ekonomik ne kontratin e qerase nr. repertori 2717, nr. koleksioni 1052, date 10.08.024. Gjithashtu, stabilimenti i deklaruar nga operatori ekonomik nuk eshte i regjistruar si vend i ushtrimit të aktivitetit as ne ekstraktin historik te regjistrimit tregtar te operatorit. KSHA gjykon se nga shqyrtimi i dokumentacionit te ngarkuar ne SPE nga OE ankimes "Gentjan Kadriu" P.F, konkretisht Licencë LN-792-05-2014, Kontrate Qiraje dhe Ekstraktin e QKB, ky OE e permbush kete kriter kerkuar ne DT. KSHA vlerson se ne te tre dokumentet e ngarkuar ne SPE dhe te permendur me siper adresa e aktivitetit ishte ne rrugen "Siri Kodra" dhe gjithashtu behet fjalë per ndertese private. Pra, adresa e stabilimentit eshte ajo adrese e cila shte pasqyruar ne ekstraktin historik te shoqerise, ne Licence dhe ne kontraten e qirase. Nëpermjet dokumenteve te paraqitura si me siper, OE "Gentjan Kadriu" PF arrin te provojte se e permbush me sukses kriterin e veçante te kualifikimit lidhur me disponimin e nje stabilimenti per kryerjen e veprimtarise ne adresën e deklaruar ne kontraten e qirase per ushtrimin e kesaj veprimtarie. **Per sa me siper, pretendimi i ankimesit qëndron.** Per keto arsye bazuar ne nenin 114 ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 102 te VKM-së nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, zyrtaret e ngarkuar per shqyrtimin e ankeses, **Vendosën:** 1- Pranimin e plote te ankeses te paraqitur nga operatori ekonomik "Gentjan Kadriu" P.F. 2- Personi pergjegjes per prokurimin te njoftojte per vendimin e marre ankimesin, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi. 3- Personi pergjegjes per prokurimin te njoftojte per vendimin e marre operatorët ekonomike te interesuar, brenda dites se neserme te

punes nga marja e ketij vendimi. 4- Personi pergjegjes per prokurimin te njoftoje per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda dites se neserme te punes nga marrja e ketij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates. 5- Ky vendim i njoftohet menjehere Titullarit te Organit Qendror Bleres”.

II.1.3. Neni 30, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.*

III.1.4. Neni 115, pika 1 dhe 2, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër. Duke qenë, se pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues “Gentjan Kadriu” PF në lidhje me skualifikimin e tij nga procedura prokurimit objekt shqyrtimi, rezulton të jetë pranuar plotësisht nga ana autoriteti kontraktor, si dhe referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit Prokurimit Publik argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236,

datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gentjan Kadriu” PF për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr. REF-11540-06-28-2024, me objekt: Loti IV “Blerje Ushqime Koloniale me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj”, me fond limit 637,906 (gjashtëqind e tridhjetë e shtatë e nëntëqind e gjashtë) lekë pa TVSH ose 6,361 (gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 27.06.2024 është 100.28 lekë nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës në zbatim të vendimit të KSHA-së Nr. 716/33 prot, datë 20.09.2024, dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Gentjan Kadriu” PF.
 4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

